



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

BORDI DREJTUES

Nr. 153/Prot.
18

Tiranë, më 15.06.2022

V E N D I M

Nr. 6, datë 15.06.2022

Bazuar në ligjin nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, neni 20, Bordi Drejtues i Institutit të Statistikave në mbledhjen e datës 13.06.2022


VENDOSI:

1. Të miratojë Planin e rishikuar të rekrutimeve për vitin 2022 sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ELSA DHULI

Sekretar i Drejtorit të Përgjithshëm
Marinela Serdani



INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta”, Nd. 35, H. 1, Njesia Administrative N. 2, Tirana, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE KOORDINIMIT

Tiranë, më _____ .2022

Lënda: Relacion mbi vendet vakante pjesë e shërbimit civil

BORDIT TË DREJTORËVE

Në zbatim të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, që nga miratimi i planit vjetor të pranimit, si pasojë e krijimit të vendeve vakante shtesë, për vijimin e procedurave të rekrutimit më poshtë gjeni informacionin mbi vendet vakante.

Këto vende vakante kanë ardhur si rezultat :

- 5 pozicione për arsye të doreheqjes dhe pezullim;
- 3 pozicione kanë ardhur si rezultat i procedurës së ngritjes në detyrë brënda institucionit;
- 1 pozicion ka ardhur si rezultat i procedurës së ngritjes në detyrë në një institucion tjetër pjesë e shërbimit civil;

Numri i vendeve vakante për miratim, pjesë e shërbimit civil, është gjithsej 9 (nëntë), i ndarë sipas kategorive të mëposhtme:

- 3 (tre) pozicione, për kategorinë e ulët drejtuese
- 6 (gjashtë) pozicione, për kategorinë ekzekutive

Pozicionet vakante janë:

1. Përgjegjës në Sektorin e Statistikave Afatshkurtra, Drejtoria e Statistikave Ekonomike, kategoria III-a;
2. Përgjegjës në Sektorin Sintezë të Llogarive Kombëtare, Drejtoria e Llogarive Kombëtare, kategoria III-a;
3. Përgjegjës në Sektorin e Llogarive Ekonomike në Bujqësi dhe Mjedis, Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit, kategoria III-a
4. Specialist në Sektorin e Statistikave të Mjedisit dhe Pyjeve, Drejtoria e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit, kategoria III-b
5. Specialist në Sektorin e Administrimit të Rrjetit dhe Serverave, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, kategoria III-b

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1, Njësia Administrative Nr.2, 1017

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE


6. Specialist në Sektorin e Metodologjisë, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, kategoria III-b
7. Specialist në Sektorin e Zhvillimin e Programeve Kompjuterike, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, kategoria III-b
8. Specialist në Sektorin e Menaxhimit të Bazës së të Dhënave dhe Aksesit në Mikrodata, Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, kategoria III-b
9. Specialist në Sektorin e Prokurimeve, Drejtoria e Financës dhe Projekteve, kategoria IV-a

Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm në kategorinë ekzekutive, janë si më poshtë:

- Informatike/Informatike Ekonomike/Inxhinieri Elektronike/Inxhinieri Telekomunikacioni / Shkenca Kompjuterike / Teknologji Informacioni
- Shkenca ekonomike/Bujqesore/Mjedisore/Pyjore/
- Shkenca matematike
- Shkenca juridike

NJËSIA PËRGJEGJËSE
DREJTOR I DREJTORISË PËRGJITHSHME
TË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE KOORDINIMIT

KLAJD SHUKA



Konc: Reita Koci, Specialist ne Sektorin e BNj
Pranoi: Vjollca Lasku, Pergjegjes ne Sektorin e Bnj

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1, Njësia Administrative Nr.2, 1017
Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al